VENDIM
Nr. 135, 13.11.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI 1.3

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.11.2015, pasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga SEE CAO dhe TSO-të aksionarë të saj, të rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.3, dhe relacionin përkatës,

konstatoi se:

- Sekretari i Energjisë (Vjenë, Austri) dhe mbledhja e 11-të e ECBR-së, mbajtur në datën 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët kombëtarë të miratojnë rregulloret e aprovuara nga SEE CAO.
- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.
-OST-ja, me shkresën nr. 5868/1 prot., datë 26.10.2015, ka kërkuar miratimin dhe hyrjen në fuqi të rregullave të ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.3, brenda datës 17.11.2015.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë rregullat e ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO, versioni 1.3 (bashkëlidhur "Rregullat e ankandit, në gjuhën origjinale angleze").
2. Drejtoria juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit Ahmeti